C. nr. 81/08

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Divizioni civil, me gjyqtaren Afijete Sada-Gllogjani dhe sekretaren juridike Vjollca Gaxha, në çështjen juridike të paditësve R. N., K. T., G. B., Gj. B. dhe P. G., punëtor të Shkollës Fillore "A. Rr." në fshati B., komuna Gjakovës, të cilët i përfaqëson B. L. avokat nga Prishtina, kundër të paditurave Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit të Komunës së Gjakovës (DAK) të cilën e përfaqëson i autorizuari B. Z. dhe Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Shërbimeve Publike në Prishtinë, të cilën e përfaqëson e autorizuara N. K., për kontest pune - kompensim të ardhurave personale, vlera kontestit 1 339.53€, në shqyrtimin kryesor të mbajtur me datë 25 shkurt 2014 në prezencën e të autorizuarve të ndërgjyqësve, murr këtë;

A K T GJ Y K I M

REFUZOHEN kërkesëpaditë e paditësve R. N., K. T., G. B., Gj. B. dhe P. G., që të gjithë nga fshati B., komuna e Gjakovës punëtor të Shkollës Fillore "A. Rr." në fshati B., komuna Gjakovës, me të cilën kanë kërkuar që të;

Detyrohen të paditurat Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit të Komunës Gjakovë dhe Ministria e Shërbimeve Publike në Prishtinë që paditësve të iu paguaj kompensimin e të ardhurave të papaguara për punën e kryer gjatë muajit nëntor dhe l0 ditë të para të muajit dhjetor të vitit 2007,

- Paditëses R. N. nga fshati B., komuna e Gjakovës për muajin nëntor 2007 shumën prej 179.45€ dhe për l0 ditë të muajit dhjetor 2007 shumën prej 67,92€ shumën e tërësishme 247.37€ (dyqind e katër dhjet e shtatë euro e tridhjeteshtatë centë).

-Paditëses K. T. nga fshati B., komuna e Gjakovës, për muajin nëntor 2007 shumën prej 197,95€ dhe për l0 ditë ta para të muajit dhjetor 2007 shumën 75.09€ shumën e tërësishme prej 273.04€ (dyqind e shtatëdhjetë tri euro e katër cent).

- Paditësit G. B. nga fshati B., komuna e Gjakovës për muajin nëntor 2007 shumën prej 197.95€ dhe për l0 ditë të muajit dhjetor 2007 shumën 75.95€ shumën e tërësishme prej 273.04€ (dyqindeshtatëdhjetetre euro e katër cent).

-Paditësit Gj. B. nga fshati B., komuna e Gjakovës për muajin nëntor 2007 shumën prej 197.95€ dhe për l0 ditë të muajit dhjetor 2007 shumën 75.95€ shumën e tërësishme prej 273.04€ (dyqindeshtatëdhjetë e tre euro e katër cent).

-Paditësit P. G. nga fshati B., komuna e Gjakovës për muajin nëntor 2007 shumën prej 197.95€ dhe për l0 ditë të muajit dhjetor 2007 shumën 75.95€ shumë e tërësishme prej 273.04€ (dyqind e shtatëdhjetë e tre euro e katër cent) me kamatë në lartësi 3.5% , siç e përcaktojnë Bankat komerciale në Kosovë, nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive **SI TË PA BAZUAR.**

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësit me padi, parashtresa dhe gjatë shqyrtimit nëpërmjet të autorizuarit të tyre kanë parashtruar se për kompensimin e punës së kryer gjatë fushatës para zgjedhore për zgjedhjet e 17 nëntorit 2007, paditësit kanë qenë në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar në Shkollën Fillore " A. Rr." në fshatin B., komuna e Gjakovës në punë dhe detyrat e punës mësimdhënës. Gjatë gjithë kohës së fushatës parazgjedhore, paditësit me rregull kanë mbajt orët e mësimit ashtu që procesi mësimor nuk ka pësuar çrregullim. Të paditurat pa të drejtë iu kanë ndalë paditësve mjetet për punën e kryer gjatë fushatës parazgjedhore (muajin nëntor dhe dhjetë ditët e para të muajit

dhjetor 2007). Të paditurat nuk i kanë përmbush në tërësi obligimet që dalin nga Udhëzimi Administrativ nr. 2003/2 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut numër 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës nga se punëtorëve nuk i është dhënë pushim pa pagesë për kohën sa zgjatë fushata elektorale dhe nuk i është siguruar zëvendësimi adekuat. Konfuzion ka shkaktuar edhe Udhëzimi Administrativ i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal nr. 2007/10 neni 1 me të cilin punëtorët e kandiduar për poste publike për kohën e fushatës parazgjedhore ju njihet e drejta në pushim me pagesë. Paditësit përmes Sindikatës së Arsimit, Shkencës dhe Kulturës së Kosovës disa herë i janë drejtuar me gojë dhe me shkrim të paditurave që të gjendet mënyra për të iu bërë pagesën e punës së kryer për muajin nëntor dhe dhjetë ditët e para të muajit dhjetor 2007, e që nuk ju është bërë gjer me tani.

Gjatë shqyrtimit i autorizuari i paditësve bëri precizimin e kërkesë padive dhe ka theksuar se nga provat e administruara është vërtetuar bazueshmëria e kërkesë padive dhe lartësia dhe ka propozua që kërkesëpaditë e paditësve të aprovohen si të bazuara.

Shpenzimet procedurale i kërkoi sipas TA, taksë gjyqësore për padi dhe aktgjykim, për përfaqësim në dy seanca nga 121.00€.

E paditura e parë me përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit përmes të autorizuarit të saj ka theksuar se të paditurës së parë i mungon legjitimiteti i plotë pasiv për të qenë palë në këtë çështje kontestuese. Në rastin konkret nuk janë përmbush prezumimet ligjore të kërkuara që e paditura e parë të jetë palë e paditur në këtë çështje kontestuese. Nga e paditura e dytë është marr vendim, përkatësisht është publikuar Urdhëresa administrative që punëtorët e shërbimit civil të Kosovës të cilët janë përfshirë në fushatën parazgjedhore të kandiduar për poste publike të ju bëhet ndalesa në të ardhurat personale për muajin nëntor dhe l0 ditë ë para të muajit dhjetor 2007. Nuk është kontestuese se paditësit kanë konkuruar në zgjedhjet e vitit 2007 se kandidatët këtu paditësit është deshtë të respektojnë Udhëzimin Administrativ 2007/10 të cilin e ka nxjerr Ministria e Pushtetit Lokal si dhe lajmërimin e Ministrisë së Shërbimeve Publike. Me aktet e përmendura është paraparë që kandidatët për zgjidhje janë të detyruar të marrin pushim pa pagesë 15 ditë para fillimit të fushatës parazgjedhore. Propozoi që padia dhe kërkesat e saj të refuzohen si të pabazuara.

Shpenzime procedurale nuk kërkoi.

E paditura e dytë me përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit nëpërmjet të autorizuarës së saj ka mohuar në tërësi padinë dhe kërkesëpaditë e paditësve si të pabazuara. Thëniet e paditësve në padi nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuara. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit kanë cilësinë e nëpunësit civil. Korniza ligjore për shërbyesit civil është Rregullorja 2001/36 dhe Urdhëresa Administrative 2003/2 për zbatim të Rregullores 2001/36. Në Urdhëresën Administrative të cekur neni 84 pika 4 thotë se" pos sekretareve të përhershëm, nëpunësve kryesor ekzekutiv dhe drejtorëve të departamenteve nëpunësit civil mund të paraqesin kandidaturën për ndonjë funksion të zgjedhur publik por ata duhet të marrin pushim pa pagesë nga shërbimi civil i cili fillon nga data kur ata publikisht i shpallin kandidaturat e tyre". E paditura e dytë me kohë ka bërë një letër Qarkore komunave ku ka kërkuar që ti dërgohen emrat e të gjithë shërbyesve civil të cilët kanë paraqitur kandidaturat e tyre për zgjedhje. Në mënyrë që ata të largohen nga lista e pagave siç i parashikojnë dispozitat ligjore në fuqi. Ministria me qëllim të zbatimit të Ligjit në fuqi vazhdimisht dhe me kohë ka njoftuar të gjitha institucionet lidhur me zbatimin e Rregullores së shërbyesve civile dhe Urdhëresës Administrative. Urdhëresa Administrative 2007/10 në të cilën thirren paditësit është në kundërshtim ne Rregulloren 2001/36 dhe Urdhëresën Administrative 2003/2 dhe ajo nuk mund të prodhoi pasoja juridike sepse sipas

hierarkisë ligjore në Republikën e Kosovës aktet ligjore nxirren nga Parlamenti dhe janë mbi çdo akt tjetër. Ndryshimet e Rregullores në fjalë mund të bëhet me procedurë të njëjtë siç është aprovuar ajo Rregullore.

Lidhur me legjitimitetin e kësaj të paditure, paditësit kontratën e punës e kanë pas të lidhur me Drejtoratin e Arsimit në Komunë. Paditësit kanë paraqitur kandidaturat e tyre dhe është deshtë të jenë në dijeni lidhur me njoftimet e lëshuara nga Qeveria dhe në rastin konkret është deshtë të veprojnë konform nenit 6 të Udhëzimit Administrativ të Qeverisë respektivisht të MAPL. U propozua që padia dhe kërkesëpaditë e paditësve të refuzohen.

Shpenzime procedurale nuk kërkoi.

Për të vendosur në këtë çështje juridike Gjykata bëri nxjerrjen e provave ku pas vlerësimit veç e veç të tyre dhe në lidhshmërinë e tyre reciproke, bazuar në rrethanat jokontestuese në mes palëve dhe nenit 8 të LPK, gjeti se kërkesëpaditë janë të pabazuara dhe u refuzuan.

Në mes palëve nuk është kontestuese rrethana se paditësit në periudhën për të cilën kërkohet kompensimi të njëjtëve nuk ju është bërë pagesa.
.
Nga vërtetimet e lëshuara nga Drejtori i Shkollës Fillore " A. Rr. vërtetohet se paditëses R. i është ndalur paga e plotë për muajin nëntor në shumë 179,45€ dhe paga për l0 ditë e para të muajit dhjetor në shumë 67.92 €, paditësve K., G., Gj. dhe P. ju është ndaluar paga e plotë për muajin nëntor në shumë nga 197.95€ dhe paga për l0 ditët e para të muajit dhjetor në shumë nga 75.09€, për vendet e punës si arsimtar. Të lartë përmendurit kanë qenë në listën zgjedhore në zgjedhjet komunale vendore të 17 nëntor 2007 dhe gjatë kohës së fushatës nuk kanë munguar asnjëherë nga procesi mësimor.

Me Listën emërore nr.382 të datës 13 maj 2010 për paditësit punëtorë të shkollës "A. Rr." në B. të cilët kanë qenë kandidat për zgjedhjet në asamblenë komunale i është ndërprerë paga gjatë muajit nëntor komplet dhe l0 ditë pune të dhjetor 2007.

Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil me datë 14 nëntor 2007 me Njoftimin për shtyp drejtuar Sekretarit të Përhershëm të MSHP-së ju ka dërguar përmbajtjen e njoftimit për shtyp për institucionet e Kosovës, nga të cilat kërkohet, edhe në atë mënyrë, informacioni lidhur me shërbyesit civil të cilët kanë kandiduar në poste publike në zgjedhjet 2007, në mënyrë që ata të largohen nga lista e pagave. Ka pasuar njoftimi për shtyp ku Ministria e Shërbimeve Publike në përmbushje të detyrimeve ligjore ka kërkuar edhe përmes njoftimit publik nga të gjitha institucionet e Kosovës të gjitha niveleve, që brenda orarit zyrtar të datës 16 nëntor 2007¸ informacioni për nëpunësit civil të cilët kanë paraqitur kandidaturat për ndonjë funksion publik në Zgjedhjet e 17 nëntorit 2007 në Kosovë, në mënyrë që ata të largohen nga listat e pagave, ashtu siç përcaktohet në aktet e mësipërme e që është fjala për Rregulloret e UNMIK-ut nr.2001/19, 2001/36 dhe Urdhëresën administrative 2003/2.

Drejtoria për Arsim dhe Shkencë në Gjakovë i është drejtuar me Kërkesën 04 Nr. Zyrt/10 janar 2008 SBASHK-u Z. Z. Z. në Prishtinë për futjen në listat e pagave të mësimdhënësve të mbetur jashtë listave për shkak të fushatës së zgjedhjeve në Kosovë. Ajo Drejtori ka konsideruar se në kuadër të Ministrisë për Arsim dhe Shkencë dhe Ministrisë së Shërbimeve Publike në Prishtinë, nuk ka pasur koordinim të mjaftueshëm të informimit të mësimdhënësve dhe të shkollave për përfshirjen e mësimdhënësve në fushatën zgjedhore lokale dhe qendrore. Nga Ministritë përkatëse, lidhur me fushatën e zgjedhjeve janë adresuar shkresa me përmbajtje të

ndryshme për të njëjtin problem. Nga ato shkresa nuk ka rezultuar se mësimdhënësit do të hiqen nga pagat, si dhe sipas udhëzimeve përkatëse të atyre Ministrive nuk do të aplikohet largimi i tyre nga listat e pagave. Në komunën e Gjakovës janë larguar nga listat e pagave 114 mësimdhënës. Të gjithë ata mësimdhënës kanë punuar rregullisht dhe kanë realizuar procesin mësimor, me kërkesë që Ministria e Shërbimeve Publike të korrigjoj vendimin e marr dhe të i fus në listën e pagave të gjithë mësimdhënësit e larguar. Kërkesë e adresuar nga Drejtoresha e Drejtorisë për Arsim dhe Shkencë në Gjakovë.

Udhëzimi Administrativ MAPL-nr. 2007/07 MAPL për përkufizimin e veprimtarisë politike të shërbyesve civil komunal datë 05 shtator 2007, neni 1 përcakton kufizimin e veprimtarisë politike të shërbyesve civil komunal, që nga momenti i themelimit të marrëdhënies së punës në shërbimin civil komunal. Neni 2 përkufizon shërbyesit civil komunal, çdo person të punësuar tek një organ në administratën komunale, rroga e të cilit paguhet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës marrëdhënia e punës e të cilit rregullohet nga legjislacioni mbi shërbimin civil në Kosovë, shërbyes i lartë civil komunal nënkupton kryeshefin ekzekutiv, drejtorin e drejtorisë komunale, udhëheqësit e sektorëve, drejtorët e shkollave e tjerë, neni 4 parasheh se shërbyesit civil komunal nuk mund të kryejnë aktivitete partiake gjatë kryerjes së punës së tij në shërbimin civil dhe duhet të ruajë paanësinë politike. Neni 6 parasheh se shërbyesit civil komunal kur paraqesin kandidaturën për ndonjë funksion të zgjedhur publik ai ose ajo duhet të marrin pushim pa pagesë 15 ditë para fushatës parazgjedhore, me qëllim që të lirohen nga përgjegjësitë dhe obligimet në shërbimin civil komunal. Neni 9 përcakton se shërbyesit civil komunal të cilët kandidojnë për ndonjë funksion publik, kanë të drejtë të kthehen në punën e tyre brenda 1(një) jave nga data e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve, në rast të mos zgjedhjes për postin publik në të cilin kanë kandiduar.

Neni 28.4 i Urdhëresës Administrative 2003/2 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/36 datë 25 janar 2003 përcakton aktivitetet politike se për pos sekretarëve të përhershëm, nëpunësve kryesor ekzekutiv dhe drejtorëve të departamenteve, nëpunësit civil mund të paraqesin kandidaturën për ndonjë funksion të zgjedhjeve publike, por ata duhet të marrin pushim pa pagesë nga shërbimi civil, i cili fillon nga data kur ata publikisht i shpallin kandidaturat e tyre. Nëpunësi civil i zgjedhur në ndonjë post publik duhet të jap dorëheqje nga data kur ai ose ajo e jep betimin ose konfirmon pranimin e postit të zgjedhur. Nëse nuk zgjidhet nëpunësi civil ka të drejtë të kthehet në punën e tij apo të saj në shërbimin civil brenda një jave nga data e shpalljeve zyrtare e rezultateve te zgjedhjeve.

Gjykata bëri vlerësimin e Udhëzimit Administrativ MAPL-nr. 2007/07 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ 2007/07 " përkufizimin e veprimtarisë politike të shërbyesve civil komunal " të datës 03 tetor 2010, ku sipas atij Udhëzimi është ndryshuar neni 6 i Udhëzimit Administrativ 2007/07 si vijon" shërbyesit civil komunal kur paraqesin kandidaturën për ndonjë funksion të zgjedhur publik ai ose ajo duhet të marrin pushim me pagesë me rastin e shpalljes së fushatës parazgjedhore me qëllim që të lirohet nga përgjegjësitë dhe obligimet në shërbimin civil komunal ", por ai Udhëzim për kah fuqia ligjore është akt më ultë se Urdhëresa administrative, andaj e njëjta duhet të jetë në përputhshmëri me te e në rast të kundërt drejtë për drejtë zbatohet urdhëresa administrative.

Bazuar në provat e administruara rezulton se kërkesëpaditë e paditësve janë të pabazuar, edhe përkundër faktit se paditësit kanë punuar në mënyrë të rregullt gjatë periudhës për të cilën kërkohen pagesat e të ardhurave personale.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u murr bazuar mos kërkesën e shpenzimeve nga pala e paditur dhe sipas nenin 450 të LPK.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
C. nr. 81/08, me datë 25 shkurt 2014

G j y q t a r j a
Afijete Sada-Gllogjani

UDHËZIM JURIDIK; Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afatin prej 7 ditësh Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet kësaj Gjykate.